



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:180472

Datë: 04.02.2021

Numri i dokumentit: 01473536

C.nr.104/2019

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË- Departamenti i Përgjithshëm-, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin Prenk Palushi, asistenten administrative Violeta Lecaj-Lulaj, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. Gj. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Bajram Mujaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “.....“ me seli nënr 5 blloku B1, të cilën e përfaqëson Hamdi Azemi, me autorizim në shkresat e lëndës, baza juridike: kompensim dëmi, pas mbajtës së seancës së shqyrtimit kryesorë me dt:28.01.2021, në të cilën prezantuan i autorizuari i paditësit si dhe i autorizuari i të paditurës me datën 04.02.2021 bije këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR**, kërkesëpadia e paditësit F. Gj. nga fsh., K....., dhe **DETYROHET** e paditura kompania e sigurimeve me seli në, që paditësit në emër te kompensimit të dëmit të gjitha llojeve të paguaj shumat si vijon:

1.Dëmi jo material:

-Në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej 7,000.00€ ;
-Në emër te frikës se përjetuar për të gjitha llojet, shumën prej 5,000.00€.

-Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 27,000.00€

-Në emër të shëmtimit shumën prej 4,000.00 €

2.Dëmi material:

-Në emër të shpenzimeve për kujdes dhe ndihmë të huaj shumën prej 480,00 euro.

-Në emër të shpenzimeve për ushqimin e përforcuar 480,00 euro.

Në emër të shpenzimeve për terapi fizikale shumën prej 900,00 euro.

Ashtu që shuma e tërësishme arrijnë vlerën prej 44,860.00 €, me kamatë 8%, e llogaritur nga dita e marrjes se aktgjykimit deri në përmbushjen definitive bashkë me shpenzimet procedurale në shumën prej 1,826.00€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit.

II. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë se paditësit mbi shumën e gjykuar dhe atë për dëme jo materialë, dhimbje fizike-trupore vlera në shumën prej 1,000.00 €, për frikën e përjetuar vlera në shumë prej 1,000.00€, për zvogëlimë të aktivitetit përgjithshëm jetësore vlera në shumë prej 3,000.00 €, për shëmtim vlera në shumë prej 1,000 €, për shpenzimet për kujdes dhe ndihmë të huaj vlera në shume prej 120,00 euro, si dhe për shpenzimet për ushqimin e përforcuar vlera në shumë prej 120,00€, që përbejnë shumën e përgjithshme prej 6,240.00 €, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi përmes të të autorizuarit të tij av.Bajram Mujaj nga Peja në seancën përgatitore, gjatë seancave të shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën e përfundimtare duke qëndruar në tërësi prapa padisë dhe kërkesës se saj të rregulluar dhe precizuar përmes parashtresës C.NR.104/19 të dt.14.02.2020, thekson se me provat e propozuara dhe të administruara nga gjykata u vërtetua në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë e paditësit, andaj kërkojmë nga gjykata se me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje juridiko-kontestimore, t'i merre parasysh të gjitha provat e propozuara dhe të administruara, e në veçanti mendimin dhe konstatimin e ekipit të ekspertëve mjekësore dorëzuar kësaj gjykate në formë të shkruar si dhe sqarimin e këtyre eksperteve, të dhënë në procesverbalin e shqyrtimit kryesorë të dt.25.02.2020, mendimin dhe konstatimin e ekipit të eksperteve mjekësor të QKUK-Prishtinë, të punuar në formë të shkruar, si dhe faktin se paditësi është i moshës së re, andaj edhe si pasojë e aksidentit të dt.03.12.2018 ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme për jetë. Nga të lartcekurat kërkojmë nga gjykata, që kërkesëpadinë e paditësit të precizuar si në parashtresën mbi rregullimin dhe precizimin e kërkesëpadisë të dt.14.02.2020, ta aprovoj si të bazuar në tërësi. Përfundon fjalën përfundimtare duke i kërkuar shpenzimet procedurale në shumën prej 1,826€ .

E paditura përmes të të autorizuarit të saj në seancën përgatitore, seancat e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën përfundimtare, duke qëndruar në tërësi prapa përgjigjes në padi, e konteston pjesërisht kërkesëpadinë për nga lartësia për dëmin jo material dhe material, për lëndime të pësuar në aksidentin e datës 03.12.2018, me arsyetimin se lartësia e dëmit material dhe jo material për lëndimet e paditësit shumat e precizuara janë jashtë çdo standardi dhe praktikë gjyqësore, andaj si të pabazuara nuk përkojnë me lëndimet e pësuar, dhe si të tilla janë në kundërshtim me praktikën gjyqësore të ardhurat për kokë të banorit në vend dhe rregulloren për përcaktimin e kriterëve, për vlerësimin e dëmit jo material nga autopërgjegjësia e miratuar në BQK, si dhe me ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Në bazë të ekspertizës të punuar nga ekspertët mjekësorë nga Nj. H.-kirurug maksillofacial, dr.F. Q.-neurokirurg, dr A. Z.–otorinolaringologji, dr.M. H.-psikiatër, e paditura ka precizuar lartësinë dëmit dhe këtë për dëme fizike vlera në shume prej 4,000.00 €, frikë të përjetuar shumën prej 2,800€, për zvogëlimë të aktivitetit jetësorë shumën prej 9,000.00€, për shëmtim trupor shumën prej 2,000.00 € shpenzimet e mjekimit shumën prej 400.00€, për rehabilitim fiziko terapeutik shumën prej 210,00 € për ndihmë të kujdesit të huaj shumën prej 210,00€, të cilat kapin vlerën për përgjithshme në shumë prej 18,830.00euro, të cilën shumë e paditura i ofron për t'ia paguar palës paditëse. Shumat e precizuara nga pala paditëse që kanë të bëjnë me shpërblimin dëmit jo material, me zvogëlim të aktivitetit jetësorë nuk janë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material, duke marrë parasysh rëndësinë e shkallës se të mirës dhe qëllimit të cilët i shërben ky shpërblim siç parashikohet me dispozita

të LMD-së.

Andaj i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit mbi shumën e ofruar prej 18,830.00 € për lëndime përkatësisht për dëmin material dhe jo material ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzime procedurale nuk i ka kërkuar

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për procedurën kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitivë të këtij aktgjykimi. Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë me që i autorizuari i palës së paditur asnjëherë nuk e ka kontestuar, madje palës paditëse i ka ofruar ofertë për arritjen e marrëveshjes.

Kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë e ofertuar nga e paditura mbi shumën prej 18,830.00 €.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë gjykata sipas propozimit të të autorizuarit së paditësit, në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën mjekësore të punuar nga dr.A. M. specialist i neurokirurgjisë, dr. Sh. M.-kirurg maksillofacial, dr. M. H. psikiatër, dhe dr.B. B. otorinolaringolog të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit të dt: 31.01.2019, kanë konstatuar se në aksidentin e komunikacionit me dt:03.12.2018, paditësi ka pësuar lëndime të renda trupore, si në vijime: lëndime të dy e me shume sistemeve të trupit, ndrydhje i indit trunorë subkortikal në regjionin frontal djathtas, prania e ajrit në hapësirën endokraniale, thyerje dhe depresion i shumëfishtë i eshtrave të kafkës në regjionin fronto bazalë djathtas, thyerje e ashtit maksillartë djathtas, thyerje e eshtrave të hundës, thyerje e kompleksit zygomatiko-maksillare djathtas me dislokim minimal, hematome rreth dy syve, gjendje pas rrjedhjes nga hunda e lëngut terrnoshpinore, plagë llacero kontuzive në regjionin frontal, plagë dekubitale dhe humbje e pilozitetit në regjionin oksipital, dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, rreth një orë nga momenti i lëndimit deri në fillimin e mjekimit dhe marrjen e terapisë kundër dhimbjeve-in tubimit në QE-Prishtinë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, që kanë zgjatur për katër dite kohë pas kohe për shkak të traumës së kokës gjatë kohës që ka qëndruar në klinikën e kirurgjisë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur për 8 (tetë) javë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët që janë prezentë edhe gjatë kësaj kohe, në sforcime fizike dhe ndryshime klimatike, frikë primare në momentin e aksidentit, në formë të frikës nga vdekja, dhe kërcënimit direkt për integritetin fizik e zgjatur për disa sekonda dhe e përcëlluar me humbje të vedijës, frikë sekondare të intensitetit të lartë, pas rikthimit të plotë të vedijës që është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti i përhershëm, çrregullim gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes, disponim të ulur, nervozë, iritabilitet, emocional, ankesa somatike, si dhe simptome tjera përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit që ka zgjatur tre javë, frikë sekondare të intensitetit mesatarë dhe me të ulët që ka zgjatur 8-12 muaj, e që është e pranishme edhe sot, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit ankciouz, zgjime të herëpashershme gjatë me rikujtime të ngjarjes traumatike, zvogëlimë të aktivitetit të përgjithshme mjekësorë 35%, shëmtim truporë i shkallës së mesme kryesisht në pjesën e kokës(ballë) dhe në hundë, i nevojshëm ka qenë kujdesia e personit tjetër si dhe ushqimi i përforcuar për tetë javë.

Meqë mendimi dhe konstatimi profesional në formën e shkruar i eksperteve mjekësorë të sipër theksuar u kontestua nga i autorizuari i palës së paditur me propozim e palëve ndërgjyqëse

gjkata caktoi marrjen e provës përmes ekspertizës nga ekspertet mjekësorë të QKUK në Prishtinë, të cilët në përbërje prej dr Nj. H. –kirurg maksillofacial, dr A. Z.-otorinolaringorolog, dr. A. M. –neurokirurg, të cilët pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësi me dt:24.11.2020, konstatojnë se në aksidentin e komunikacionit me dt 03.12.2018 paditësi ka pësuar, këto lëndime trupore: Polytrauma(lëndimet e dy e me shume sistemeve trupore), Contusio crebi haemorrhagica subcorticalis re Frontalis lat dex(ndrydhje e indit trunor subkortikal në regjionin frontal djathtas), Pneumocephallus(Prania e ajrit në hapësirën endokraniale), Fractura cranii depressive multifragmenaria reg. Fronto-basalis lat dex(thyerje e ashtit dhe depresioni shumëfishtë i eshtrave të kafkës në regjionin front bazala djathtas). Fractura maxillae lat dex (thyerje e ashtit maksillar djathtas), Fractura ossium nasarium (thyerje e eshtrave të hundës), Fractura complexus zygomatico-maxillaris lat dex cum dislocationrm minimalis (thyerje e komplekse zygomatiko-maksillar djathtas me dislokim minimal), Haematoma retrobulbaris bill (hematoma rreth dy syve), St.Post Rinoliquorrhea (gjendje pas rrjedhjes nga hunda e lëngut truno-shpinor), VLCreg.Frontalis(plage lacero kontuzive në regjionin frontal), Decubitus reg Occipitalis (plagë dekutabile dhe humbje e pilozitetit në regjionin occipital, dhembje fizike të intensitetit posaçërisht te lartë, ka patur rreth një orë, prej momentit të lëndimit, deri në fillimin e mjekimit, dhe marrjen e terapisë kundër dhimbjeve në QE-Prishtinë, dhembje me intensitet të lartë ka patur për 7 ditë, kohë pas kohe për shkak të traumës së kokës, dhembje të intensitetit të mesëm, për tetë javë, për shkak të dhembjeve të përjetuara për shkak të aksidentit, dhembje të intensitetit të ulët, që janë të pranishme edhe sot kohë pas kohe e sidomos gjatë ndryshimit të kushteve klimatike, zvogëlim i aktiviteteve të përhershëm mjekësorë –kapitulli I pika 1.1.4 lëndim morfologjik i trurit me funksion të dëmtuar cerebrale,(marramendje, çrregullime në baraspeshë, qëndrime në këmbë, dhe ecje) 35%.

Në këtë përqindje përfshihen të gjitha lëndimet e kokës dhe të fytyrës, shëmtime truporë të dukshme të shkallës së mesme (dhe deformim në ballë) pjesën okcipitale të kokës, pjesës së fytyrës dhe hundës, përkujdesje personit të tretë në kohëzgjatje prej 8 (tetë) javësh, për shkak të lëndimeve të shumta të kokës, ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 8 javësh, terapi dhe rehabilitim në kohëzgjatje prej dy javësh me përcjelle, e më pas pa përcjellës.

Me këto prova të administruara gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shume prej 7,000.00€ dhe vlerësoi si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertit si pasojë e lëndimeve të marra ka dhimbje të intensitetit posaçërisht lëndim të kokës dy e me shumë sistemeve trupore, thyerje dhe depresion i shumëfishtë i eshtrave të kafkës në regjionin front baza djathtas si dhe thyerje e ashtit maksillar dhe eshtrave të hundës.

Në emër të frikës se pësuar gjykata ka caktuar shpërblim në shume prej 5,000.00€. dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor, paditësi ka pësuar frike primare të manifestuar në formë të frikës së vdekjes dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij fizike që ka zgjatë për disa sekonda dhe është përcjelle me humbje të vedijës, si dhe frike sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatuar disa dite, nga invaliditeti i përhershëm.

Në emër të shëmtimit të pësuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 4,000.00 € dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza, të paditësi është prezentë shëmtimin trupor i shkallës së mesme (deformim në ballë pjesën okcipitale të kokës të pjesës së fytyrës dhe hundës).

Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor gjykata ka caktuar shpërblimin në shumën prej 27,000.00, dhe ka vlerësuar si shpërblim duke u nisur nga mendimi dhe konstatimi

i eksperteve mjekësore të cilat kanë arritur deri tek përfundimi se paditësi me rastin e aksidentit në komunikacion ka pësuar zvogëlim të përgjithshëm jetësorë dhe atë të natyrës së përhershme, i manifestuar si lëndime morfologjike i trurit me funksion të dëmtuar cerebral, i llogaritu sipas formulës së baltazarit në 35%.

Sa i përketë shumave të kompensimit të dëmit material i shprehur përmes ushqimit të përforcuar dhe ndihmës e kujdesit të huaj të cilat janë të caktuara nga gjykata në shumën e përgjithshme prej 960,00 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 480,00euro si dhe 480 euro për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, gjykata konsideron që një kompensim i tillë i vendosur si në piken I nën pika 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm, kjo pasi që format e tilla të dëmit është vështirë, po thuajse e pamundur të vërtetohen me prova konkrete materiale, por praktika e gjykatave të Kosovës njeh forma të tilla të kompensimit sa here konstatohet nevoja për to. Kështu me që në këtë rast është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 8 javësh dhe për ndihmë e kujdes nga personi tretë gjithashtu në kohëzgjatje prej tetë javësh, atëherë vërtetohet se të dëmtuarit i takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit duke llogaritur nga praktika gjyqësore 1(një) ditë me 8(tetë) euro.

Ndërkaq shpërblimin materialë i shprehur në shpenzime për shërim, terapi fizikale, barëra dhe medikamente gjykata i caktoi shumën prej 900,00 euro, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë në bazë të provave materiale, të prezantuara nga pala paditëse.

Ekspertizat e përmendura gjykata i mori në tërësi si të bazuara dhe ua dha besimin plotë, këtë se ekspertizat përmbajnë elemente të nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësit me rastin e lëndimit gjatë aksidentit për çka e paditura është e obliguar që paditësit ti kompensoj dëmin e bërë nga e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë TPL (sigurimin e detyrueshëm për palët e treta) konfrom nenit 159, 169, 170, Ligjit mbi Marrëdhëniet e detyrimeve, ngase është vërtetuar saktësisht se paditësi ka pësuar lëndime te enda trupore me rastin e aksidentit te cilin e ka shkaktuar i siguruari i të paditurës me automjetin me polisë valide të sigurimit, prandaj e njëjta është e obliguar këto dëme t'i kompensoj paditësit konfrom dispozitave ligjore të nenit 18 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia dhe ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve .

Me dispozitën e nenit 182, 183 të LMD-së, janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e pësuar fizike, për frikën e pësuar, zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtim etj.

Duke u bazuar në dispozita e lartëcekura si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë se shpërblimi te demit jo material, e posaçërisht duke marre natyrën dhe shkallen e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, moshën e tij, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata miratojë kërkesëpadinë e paditësit në vlerat e shpërblimit të dëmit si në piken 1 të dispozitiv të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblimin real, objektiv, dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit, që paraqesin kompensim të drejtë dhe satisfaksion real për të rivendosur drejtë peshimin shpirtëror te çrregulluar të paditësit, për çka edhe është qëllimi i këtij kompensimi. Kurrsesi këto shuma nuk paraqesin thjeshtë qëllime fitimprurëse të paditësit, gjithnjë duke u përkuajdesur, që kompensimi të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, frikës, shëmtimit zvogëlimi të përhershëm të aktivitetit jetësor të të dëmtuarit këtu paditësi

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material dhe material gjykata vendosi si në dispozitav të aktgjykimit pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës se gjykuar nuk ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë

Gjykata konsideron se shumat e gjykuara si në dispozitave të këtij aktgjykimi paraqesin satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar të paditësit në aksidentin e komunikacionit, lëndimit dhe pasojave duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara të ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve. standardin jetësor të qytetareve të Kosovës dhe praktikën e deritanishme të gjykatave të Kosovës.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur ne mbështetje të nenit 170,382 të LMD-së, si dhe duke u bazuar praktikën gjyqësore, se kamatëvonesa për shpërblimin e demit material jo monetarë dhe ajo për shpërblimin real të demit jo material, rrjedh nga dita e marrjes se aktgjykimit ne shkallë të parë me të cilin është caktuar masa e shpërblimit dhe jo nga dita e paraqitjes e padisë me arsyetimin se i njëjti është dëme natyrorë andaj si i tille nuk e ka karakterin e detyrimit në të holla në kuptim të nenit 394 te LMD-së për tu llogaritu nga dita e mënjanimi të demit. Andaj në këtë kontekst gjykata ka vendosur si në pikën I.2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar kërkesëpadinë sa i përketë llogaritjes se kamatës nga data e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazua në dispozitat e neneve 449 dhe 452.1 të LPK-së si dhe ne tarifën e avokateve te Kosovës, ashtu që është obliguar e paditura t'ia paguaj te autorizuarit të paditësit për përpilimin e padisë vlera në shume prej 208,00 euro, për taksen gjyqësore për padi vlera ne shume prej 150,00, përpilimi i parashtresës për rregullimin dhe precizimin e padisë vlera ne shume prej 208,00 euro, për shpërblimin për ekspert mjekësorë vlera në shumë prej 450,00 euro, për tri seanca të mbajtura nga 270,00 euro, vlera ne shumë prej 810,00 euro, që përbejnë shumën e përgjithshme prej 1,826.00€

Mbi bazën e të lartshënuarve u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj nga arsyet e theksuara më lartë konfrom dispozitave ligjore te nenit 142, dhe 145 u vendosi si në dispozitivit të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.104/2019 dt: 04.02.2021

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate

Gj y q t a r i
Prek Palushi